



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.07.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me zotin Ditmir Bushati, Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme, për situatën dhe përgatitjet e procesit të negociatave me BE-në, në vijim të konkluzioneve të Këshillit të BE-së; për vlerësimin e konkluzioneve të Samitit të Londrës për Procesin e Berlinit, datë 9-10 korrik 2018 dhe Samitit të NATO-s, datë 11-12 korrik 2018

2. Çështje të tjera

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Evis Kushi, Klajda Gjoshaj, Xhemal Qefalia, Edmond Panariti, Nard Ndoka, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Tritan Shehu, Rudina Hajdari, Klevis Balliu, Vasilika Hysi

Mungojnë:

Edi Paloka, Ervin Bushati

Të ftuar:

Ditmir Bushati - Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Odeta Barbullushi - Drejtore e Kabinetit në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Sokol Dedja - Drejtor i Drejtorisë së BE-së

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita, të gjithëve!

Dua të përshëndes kolegët deputetë që kanë ardhur në këtë seancë dëgjimore, që do të zhvillohet me ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme, të cilët nuk janë pjesë e komisionit, por kanë interes të madh për çështjet që do të diskutohen.

Pa humbur kohë, fillojmë me mbledhjen e komisionit me të ftuarin tonë, zotin Ditmir Bushati, ministër për Europën dhe Punët e Jashtme për situatën dhe përgatitjen e procesit të negociatave me Bashkimin European, në vijim të konkluzioneve të Këshillit të Bashkimit European.

Një çështje tjetër për të cilën kemi interes të dëgjojmë ministrin është vlerësimi i konkluzioneve të dala nga Samiti i Londrës për Procesin e Berlinit, i zhvilluar në datat 9-10 korrik të këtij viti, si dhe Samitin e NATO-s, të zhvilluar në Bruksel në datat 11- 12 korrik.

Të ftuar, përveç ministrit, janë zonja Barbullushi dhe zoti Dedja, drejtor i Bashkimit European.

Edhe një herë do të kërkoja miqësisht vëmendjen dhe qetësinë tuaj, në mënyrë që ta dëgjojmë ministrin për çka do të ndajë sot me ne.

Zoti Bushati, faleminderit që keni ardhur!

Fjala për ju.

Ditmir Bushati – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, të nderuar deputetë!

Për interesin e shtuar në lidhje me këtë proces, do t'ju flas shumë shkurt për tri çështje për të cilat po organizohet kjo seancë dëgjimore, në mënyrë që të kemi mundësi të këmbejmë ndonjë ide apo pikëpamje tjetër më pas.

Së pari, për sa u përket konkluzioneve të Këshillit të Bashkimit European dhe asaj çka nisi dhe në lidhje me punën përgatitore për procesin e hapjes së bisedimeve për anëtarësim, e djeshmja ishte në përputhje me mandatin që i dhanë vendet anëtare Komisionit European për të nisur punën përgatitore me Shqipërinë. E djeshmja zyrtarizoi nisjen e procesit të *screening*, ose ndryshe procesi analitik, sipas të cilit i gjithë legjislacioni i Bashkimit European, i ndarë në kapituj të ndryshëm, do t'i shpjegohet administratës shqiptare, në radhë të parë, për të bërë një inventar të qartë të nivelit

të përputhshmërisë së ligjeve dhe politikave të Shqipërisë në raport me procesin e anëtarësimit në BE; në radhë të dytë, për të përcaktuar rrugën dhe hapat që duhet të ndjekë Shqipëria, qoftë në hapa të karakterit ligjor dhe institucional, qoftë në hapa të tjerë, që mund të kenë impakt të drejtpërdrejtë për sa i përket zhvillimit ekonomik e shoqëror në këtë proces.

Dje ramë dakord me Komisionin European për një kalendar, i cili fillon në shtator për t'u mbyllur në pranverën e vitit 2019. Në bazë të këtij kalendari dhe aktiviteteve të ndërmjetme që do të zhvillohen gjatë këtij viti, e gjithë gama e detyrimeve dhe angazhimeve që do të ndërmarrë Shqipëria në këtë proces do të ekspozohet pranë strukturave shtetërore.

E një rëndësie të veçantë është mënyra sesi po përpiqemi ne për të konverguar dy procese, të cilat ushqejnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin. Në njërin anë kemi procesin e zbatimit të detyrimeve, që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim -Asocimit, proces, i cili do të vijojë deri ditën që Shqipëria do të anëtarësohet në Bashkimin European. Nga ky proces derivojnë disa struktura të përbashkëta duke filluar nga Këshilli i Stabilizim - Asocimit, që është struktura më e lartë ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, për të vijuar më pas me Komitetin e Stabilizim Asocimit dhe me nënkomitetet sektoriale me atë proces dhe strukturë që do të jetë edhe struktura kryesore koordinuese e procesit të bisedimeve për anëtarësim.

Për sa i përket koordinimit të procesit *screening*, siç mund të jeni vënë në dijeni edhe nga takimi i përbashkët i djeshëm i qeverisë me Komisionin European, ky proces, duke filluar që mbrëmë, do të ketë një koordinator teknik. E gjithë puna që do të përfshijë institucionet shtetërore do të koordinohet nga koordinatori teknik me mbështetjen e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Sa i përket konceptit të negociatave, e kam thënë edhe radhën e kaluar në këtë komision, duke përfituar nga rasti që sot është edhe Partia Demokratike këtu, ritheksoj se kemi një bazë të mirë, janë të paktën 2-3 projekte të asistencës së BE-së, që kanë punuar me ekspertët e ish-Ministrisë së Integritetit European dhe, natyrisht, pak a shumë modelet konvergojnë të gjitha në një pikë, do të ketë një delegacion shtetëror që do të udhëhiqet nga ministri i Jashtëm, do të ketë një ekip për procesin e *screening*, që më pas do të transformohet në ekipin negociator të këtij procesi të rëndësishëm.

Vijoj të theksoj se më i rëndësishëm se puna e kësaj strukture koordinuese, do të jetë procesi i angazhimeve dhe gatishmërisë së të gjitha institucioneve të shtetit shqiptar në këtë

drejtim, sepse puna e strukturës koordinuese, në një mënyrë apo një tjetër, do të varet nga gatishmëria e këtyre institucioneve.

Pika e fundit në lidhje me këtë çështje, ka të bëjë edhe me konkluzionet e Këshillit të BE-së deri në fillimin e vjeshtës, që përkon edhe me fillimin e procesit të *screening*, që do të kompletohet nga pikëpamja e akteve normative. Konkluzionet e Këshillit detajojnë procesin e nisur të reformave, sidomos për sa u përket fushave që kanë lidhje me sundimin e së drejtës në ekonomi. Ne si institucion përgjegjës për bashkërendimin e këtij procesi dhe dialogu me Komisionin Europian dhe me vendet anëtare, jemi duke i transformuar konkluzionet e Këshillit në një plan pune të përbashkët me disa institucione shqiptare. Natyrisht, një pjesë e institucioneve që preken, le të themi, nga konkluzionet e Këshillit të Ministrave të Bashkimit Europian, shkojnë përtej suazës së punës së ekzekutivit dhe në këtë drejtim, një klimë më mirëkuptuese politike, veçse do ta ndihmonte përparimin e Shqipërisë në këtë proces. Në funksion të vitit 2019, siç u tha shumë qartë nga ana e Komisionit Europian dhe Komisionerit për Zgjerimin, zotit Han, negociatat janë në horizontin e këtij viti. Komisioneri përcaktoi edhe afatin për hapjen e kapitujve të parë negociues, por besoj se nga gjithë puna dhe analiza e bërë me Komisionin, me fqinjët tanë, me Shkupin, i cili ka nisur të njëjtin proces dje, mendohet që viti 2019 dhe ai plan që ka përcaktuar Komisioni në bazë të mandatit të marrë nga vendet anëtare dhe në bashkëpunim me ne, është plotësisht i arritshëm.

Pika e dytë, që ka lidhje edhe me pikën e parë, të cilën e keni përcaktuar në axhendë, ka të bëjë me Samitin e Londrës. Realisht vlerësoj ata pak deputetë nga opozita, të cilët kanë kontribuar në rrjetet sociale me qëndrimet e tyre rreth Samitit.

Më duhet të them se në çdo samit, përgjithësisht bie dakord, në radhë të parë, për vendin ku do zhvillohet dhe më pas për menynë e diskutimit. Nuk kanë qenë të paktë kolegët dhe politikanët që kanë pasur një lloj vështirësie kur është bërë propozimi për t'u mbajtur Samiti në Londër, për vetë faktin se ky vit është përcaktues për të ardhmen e negociatave të divorcit mes Mbretërisë së Bashkuar dhe BE-së, por nga ana tjetër është konsideruar edhe si një mundësi e mirë për të rikonfirmuar apo riafirmuar politikat, kryesisht në fushën e sigurisë, që Mbretëria e Bashkuar ndjek në Ballkanin Perëndimor. Është kjo arsyeja që për herë të parë në këtë samit, kishim çështje që kanë lidhje me sigurinë, në konceptin jo të ngushtë të fjalës, pra jo thjesht çështje që kanë lidhje me korrupsionin, krimin e organizuar, por edhe për çështje, të cilat lidhen me historinë e rajonit tonë, ndoshta jo domosdoshmërisht me Shqipërinë, siç është çështja dhe deklarata që u bë për të

zhdukurit gjatë konfliktit në ish-Jugosllavi. Duhet thënë që në këtë samit u krijua një lloj sinergjie mes axhendës së konektivitetit apo ndërlidhshmërisë së rajonit, axhendës që ka lidhje me tregun apo me implementimin e detyrimeve që burojnë nga zona ekonomike, që është në proces krijimi në rajonin tonë dhe çështjet që kanë lidhje me sigurinë, procese këto që impaktojnë njëra-tjetrën. Po kështu, edhe formati i bisedave në nivelin e kryeministrave, ministrave të Jashtëm, ministrave të Brendshëm dhe ministrave të Ekonomisë, të cilët u takuan në vigjilje të samitit në Vjenë.

Më lejoni të ndaj me ju një risi tjetër të samitit në lidhje me krijimin e fondit të garancisë për sa u përket SME-ve: rreth 150 milionë euro do të jenë në dispozicion të SME-ve dhe projekteve të ndryshme që do të zbatohen edhe në funksion të zonës ekonomike në rajonin tonë.

Samiti i Londrës, gjithashtu, konfirmoi një angazhim të ripërtërirë të Mbretërisë së Bashkuar, ku në dispozicion të vitit të ardhshëm u vendosën rreth 41 milionë paund, si edhe 80 milionë paund për projekte që kanë lidhje me periudhën 2020-2021.

Fokusi është tek të rinjtë dhe axhenda dixhitale që impaktojnë zhvillimet në ekonomi dhe kryesisht krijojnë një rrjet më të madh të të rinjve në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Me të njëjtën logjikë, vitin tjetër do të mbahet samiti në Poloni, në Poznan. Jemi në fazën e diskutimit për tematikat që do të duhet të mbulojë ky samit.

Mund t'ju them që në fund të gushtit, ashtu siç u zhvillua edhe vjet, do të mbahet takimi i kryeministrave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Durrës, në bashkëpunim me presidencën austriake të Bashkimit Europian, me Komisionin Europian, BERZH dhe me Bankën Botërore, një proces konsultativ ky, që në radhë të parë do të na ndihmojë për të kuptuar se ku jemi me zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Procesi i Berlinit, gjithashtu, do të skicojmë më tej edhe hartën e rrugës që do të ndiqet në mbajtjen e samitit në Poloni.

Ka pasur një keqkuptim, interpretim apo ndonjë opinion në lidhje me axhendën e samitit nga deputetë të caktuar të opozitës për sa u përket çështjeve të sigurisë, por kjo ka qenë një menu dhe një axhendë për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Shpresoj, nga qëndrimet e djeshme të Komisionerit për Zgjerimin qoftë për reformën në drejtësi, qoftë për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, të jetë fashitur ky qëndrim, edhe për ata që besojnë se në fund të 2019-ës komisionerit i mbaron mandati, siç u mbaron mandati të gjithë anëtarëve të Komisionit Europian.

E treta, jo më pak e rëndësishme edhe për shkak të debatit të madh mediatik ndërkombëtar, ka lidhje me samitin e NATO-s në Bruksel. Nuk besoj të ketë ndonjë komision apo ndonjë forum

më të mirë sesa ky për të diskutuar disa prej çështjeve që ishin pjesë e diskutimeve kryesore, qoftë për sa u përket angazhimeve financiare, por jo vetëm, apo ajo siç njihet ndryshe barra që mbajnë vendet anëtare në këtë aleancë sa u takon operacioneve të ndryshme ushtarake, por edhe në investimet që bëhen për zhvillimin e politikave të mbrojtjes. Media ndërkombëtare i ka reflektuar gjerësisht diskutimet që janë bërë në samit, mund të thuhet fare qartë që edhe në bazë të raportimit të shifrave nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, Shqipëria ka një projektion mjaft pozitiv, e vlerësuar edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat ishin forca apo motori kryesor lëvizës në insistimin që kishin ndaj vendeve të tjera për të rritur shpenzimet në fushën e mbrojtjes.

Sipas raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Shqipëria përllëgaritet e katërta në raport me GDP-në, për sa i përket rritjes që ka në këtë drejtim. Një çështje tjetër mjaft e rëndësishme e samitit kishte të bënte me konfirmimin e politikës së dyerve të hapura qoftë me ftesën që iu dha fqinjit tonë, që në të ardhmen e afërt do të quhet Maqedonia e Veriut apo edhe në rikonfirmimin në të njëjtën linjë si me Samitin e Uellsit dhe me Samitin e Varshavës të rëndësishme strategjike të Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, jemi të gazuar për sa i takon gjuhës që adopton Samiti i Brukselit në lidhje me ambiciet e Kosovës për të pasur një marrëdhënie më të institucionalizuar me NATO-n, edhe në kushtet kur misioni më i madh i NATO-s sot për sot KEIFOR-i, është i stacionuar në Kosovë.

Temat e tjera të diskutimit në samit kishin lidhje qoftë me projektimin e stabilitetit kryesisht në Lindjen e Mesme, edhe për shkak të situatës së paprecedentë dhe impaktit që sjell kriza e refugjatëve për të gjithë arkitekturën e sigurisë europiane, sikundër edhe me paketën e masave që u adoptuan qoftë për misionin në Irak apo për modernizimin e mëtejshëm të NATO-s.

Si pikë të fundit që doja ta ndaja me ju, por jo më pak e rëndësishme, është ndërveprimi ndërmjet dy organizatave të rëndësishme, në njërën prej të cilave ne jemi anëtar në NATO dhe në tjetrën, ku aderojmë të jemi, Bashkimi European. Edhe në këtë samit ne kemi një rikonfirmim të aleancës së fortë që ekziston ndërmjet dy prej organizatave më të fuqishme sot për sot në botë, njëra për sa i përket aspektit të sigurisë dhe atij ushtarak dhe tjetra për sa i përket pushtetit të butë dhe programeve të ndryshme, të cilat i aplikon.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

Nënkryetari i komisionit, zoti Shehu, e ka kërkuar fjalën. Më pas fjalën e ka kërkuar zonja Gjoshaj, zoti Panariti e më pas me radhë të tjerët.

Sigurisht do të kemi...

(Diskutime pa mikrofon)

Mund të ishe edhe ministre Drejtësie, sepse je e drejtë në vendimmarrje.

Ju kërkoj ndjesë!

Unë kisha diçka për të ndarë me ju, nënkryetar, do të bëni pyetje apo keni vetëm komente?

Unë besoj se do të bëjmë në fillim pyetjet dhe më pas do të kalojmë në diskutime, prandaj nëse keni pyetje precize...

Tritan Shehu – Radha kërkohet për të folur, se çfarë do të flas e di unë...

Mimi Kodheli – Me Rregullore është e ndarë...

Tritan Shehu – Ju jeni kryetare e komisionit, mund të bëni pyetje ose të flisni, ky është problemi juaj. Problemi im është imi, unë mund të bëj pyetje ose mund të diskutoj...

Mimi Kodheli – Patjetër!

Tritan Shehu – T'ju them se do të bëj pyetje dhe më pas të rri 1 orë duke folur, mund ta bëj edhe këtë, por dua të jem korrekt.

Mimi Kodheli – Kjo është tipike juaja, zoti Tritan.

Tritan Shehu – Unë e kërkoj fjalën.

Mimi Kodheli – Sipas Rregullores në fillim bëhen pyetjet, merren përgjigjet dhe më pas fillohet me diskutimin.

Në qoftë se doni të diskutoni do ta merrni fjalën menjëherë pas fjalës sime.

Zoti Ministër,

Kisha një pyetje për ju, meqë në komision janë të pranishëm edhe dy kryenegociatorët. E kuptoj që politikisht ndoshta në periudha negociatash apo hapje kapitujsh qëndron fakti që sa më shumë kapituj të hapen për diskutim aq më mirë është. Hapja e kapitujve nuk do të fillojë nesër, ka filluar më parë, ish-ministrja Gjoshaj pa dyshim di shumë më tepër se sa unë dhe mund të flas për këtë gjë. Në teknikat tuaja të punës, në programin dhe axhendën që ju do t'i vendosni vetes, a mendoni se do të hapim kapituj dhe do të jemi në diskutim të shumë kapitujve? Kjo mund të qëndrojë politikisht duke thënë: kemi hapur kaq dhe aq apo mendoni se do të hapni më pak kapituj, do t'i mbyllni ato kapituj që keni nisur dhe do të rihapni të tjerë?

Ky mbase është një teknikalitet që publikut i intereson pak, por meqë në komision kemi të pranishëm shumë ekspertë të procesit, doja një opinion tuajin. Kjo ishte pyetja që kisha për ju.

Faleminderit!

Ditmir Bushati – Çështja e hapjes së kapitujve nuk është thjesht teknike, sado që në pamje të parë procesi duket paksa i koklavitur. Normalisht, Komisioni Evropian bën shpjegimin e detyrimeve që burojnë nga kapitulli, më pas vendi që është në proces negocimi duhet të prezantojë se ku qëndron në raport me gamën e detyrimeve që burojnë nga kapituj dhe mbi bazën e këtij procesi Komisioni Evropian përgatit atë që njihet ndryshe si *Screening Report* ose raporti *Screening*. Raporti *Screening* nuk diskutohet më me vendin që është në proces negocimi, por diskutohet me vendet anëtare. Të gjitha vendet anëtare duhet të bien dakord për gjetjet e Komisionit Evropian në *Screening Report* dhe mbi bazën e *Screening Report* përcaktohen ato që njihen ndryshe si *Opening Benchmarks* ose kushtet për t'u plotësuar në mënyrë që të nisin bisedimet për një kapitull të caktuar.

Ka praktika nga më të ndryshmet, nuk ka rëndësi se sa kapituj hapen, por më shumë rëndësi ka se sa kapituj mbyll, sepse, siç kemi edhe rastin e fqinjëve, ndoshta nuk është rasti që unë të bëj analiza për ta, por edhe nga kontaktet që ne kemi qoftë në nivel ekspertësh apo edhe me përfaqësues të institucioneve të Bashkimit Evropian, vrulli për të hapur sa më shumë kapituj nuk përkthehet domosdoshmërisht në rritje të cilësisë së jetesës.

Ju thatë se nuk e dimë nëse kjo gjë u intereson qytetarëve, por në fund të ditës ajo çka u intereson qytetarëve, pavarësisht se për kë votojnë, është rritja e standardeve të jetesës. I gjithë ky proces përafrimi ligjesh, institucionesh ka të bëjë me normimin e jetës sonë institucionale gradualisht mbi bazën e parimeve të *acqui communautaire*. Ne sot për sot nuk jemi te kjo fazë, por jemi te fillimi i këtij procesi, ai fillim që kishte edhe Mali i Zi para disa vitesh apo Serbia mbi bazën e precedentëve të vendosur si në rastin e Malit të Zi, ashtu edhe në rastin e Serbisë.

Po dëgjoj zotin Shehu, i cili thotë se nuk është kështu. Mund t'ju them se në qoftë se do t'i referohemi strikt traktatit të Bashkimit Evropian, *Procesi Screening* nis pasi zyrtarizohet hapja e negociatave. Ky është rregulli i përcaktuar në traktat, por nga ana tjetër dimë që procesi i zgjerimit funksionon mbi bazën e precedentëve dhe është kodifikuar mbi bazën e precedentëve. Ishte Mali i Zi, rasti i parë ku Bashkimi Evropian e theu këtë lloj tradite dhe vendosi një rregull tjetër, duke nisur *Procesin Screening* para zyrtarizimit të bisedimeve për anëtarësim, duke vendosur për hir të së vërtetës në rastin e Malit të Zi një periudhë 6-mujore, siç është periudha 1-vjeçare në rastin e Shqipërisë dhe të Maqedonisë.

Edhe për rastin e Serbisë vendet anëtare ndoqën të njëjtin precedent, duke vendosur një afat kohor. Mund t'ju them se afati kohor në rastin e Serbisë nuk u arrit dot. Serbia zyrtarisht i ka

filluar bisedimet 18 muaj pasi nisi ky proces, që ne e nisëm dje së bashku me Maqedoninë. Çështja që shtrohet është se si do të mobilizohemi në kuptimin politik të fjalës, në kuptimin e të gjitha kapaciteteve ekzistuese, qofshin këto në administratën publike, në shoqëri, por edhe më gjerë, pra edhe për shqiptarët që jetojnë dhe punojnë jashtë atdheut, sepse procesi në vlerësimin tonë dhe në vlerësimin tim personal, po të doni, është ekstremisht sfidues, është ekstremisht i vështirë, sepse para nesh shtrohet një gamë shumë e madhe çështjesh. Më e pakta që mund të thuhet për këtë proces është se njerëzit që janë në krye të detyrës, sidomos, po flas duke për personat teknikë meritojnë inkurajim dhe mbështetje nga të gjitha krahët e politikës.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Shehu, fjala për ju.

Tritan Shehu – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër, për ekspozenë që na paraqitët, por realisht nuk thatë asgjë! Nuk thatë asgjë, sepse u shmangët, nuk donit të preknit të vërtetën pasi ajo ju djeg, por realisht ajo e vërtetë djeg të gjithë Shqipërinë dhe dëmton rëndë aspiratën tonë europiane.

Ju thatë se këtu në komision janë të pranishëm shumë anëtarë të opozitës, kjo është mëse e vërtetë, pasi çështja që po diskutojmë është tejet e rëndësishme për vendin, është objektivi kryesor i Shqipërisë, ka të bëjë me integrimin europian. Ju u përpoqët që ta përzienit me samitin e kësaj apo me samitin e asaj, pikërisht për t'i bërë bisht përgjigjeve që lidhen me këtë çështje thelbësore të vendit, ku fatkeqësisht, e theksoj shumë këtë, dështuat, duke i krijuar një dëm të madh vendit.

Fjalën time do ta nis me një pyetje për ju, zoti Ministër, meqenëse edhe kryetarja e komisionit donte ta fillonim me pyetje: a do të jepni dorëheqjen ju dhe qeveria juaj deri në shtator, zoti Ministër? A mundet të qëndrojë më kjo qeveri dhe Kryeministri juaj në krye të vendit, pasi ju ra flamuri, pika kryesore e programit dhe aspirata e madhe e Shqipërisë dhe ëndrra që ne kishim u ngadalësua në rrugën e integrimit europian?

Pra, a keni ju në veten tuaj një përgjegjësi morale për të thënë mjaft më, dështuam, nuk jemi të aftë ta bëjmë këtë gjë, japim dorëheqjen? A ka Kryeministri një përgjegjësi morale ta thotë një fjalë të tillë dhe të mos thotë ashtu siç tha dje, disa shprehje lakonike, që edhe filozofët e Greqisë së Vjetër apo të Romës nuk besoj se do t'ua gjenin fillin. Kryeministri tha: “Është hapur rruga për shtratin e negociatave”. Rruga për shtratin e negociatave është hapur që në dhjetor të 1990-ës, kur ne thirrëm “E duam Shqipërinë si gjithë Europa”, që nga ai moment e krijuam shtratin

e negociatave, shtratin e integritit, vendosëm piketat e rrugës, të cilat ju po i pengoni dhe po bllokoni. Prandaj unë po ju pyes shumë seriozisht: a keni ndjenjë përgjegjësie? A nuk ka ardhur momenti që të largoheni, që qeveria dhe Kryeministri juaj të japin dorëheqjen? Sepse, realisht, shkak i dështimit është shumë i gjerë, është shumë kompleks, lidhet me problemet madhore të vendit, kurse ju bëni lojëra fjalësh. Ju ngatërroni *screening*-un, me hapjen e negociatave, kur e dini shumë mirë se nuk kanë lidhje fare, sepse janë dy procese të ndryshme.

E para, është një proces teknik, që edhe vetë komisioneri Hahn e tha qartësisht dje për vendet kandidate.

E dyta, është hapja e negociatave, si një hap i madh strategjik, politik i Shqipërisë. A keni garanci ju që vitin tjetër do të hapen negociatat? Po sikur të mos hapen në qershor të vitit të ardhëm? Ku është e shkruar që në qershor të vitit të ardhshëm do të hapen negociatat? Ju keni qenë edhe pedagog dhe e dini shumë mirë se çfarë është provimi! Fatkeqësisht, prej jush, Shqipëria ngeli në këtë provim dhe ata thanë: “Hajdeni pas një viti, që ta jepni edhe një herë provimin!”, por kjo nuk do të thotë se ata thanë: “Hajdeni se do t’jua falim provimin vitin tjetër!”. Asnjëri nuk e tha një gjë të tillë, madje na shtuan edhe kushte të tjera, duke u involvuar thellësisht te parlamentet e tjera, siç është Bundenstagu gjerman, që ju e kuptoni vetë rëndësinë e tij, i cili shtoi si kusht luftën kundër drogës, mbështetjen e azilantëve, elemente të zgjedhjeve, si dhe çështjen e Gjykatës Kushtetuese, që ne i keni vënë çelësin. Pa dyshim një shtet pa Gjykatë Kushtetuese, ku, shumë shpejt, rrezikon që të mos ketë as Gjykatë të Lartë, nuk mund të ketë demokraci. Demokracia është e përdhosur, ndaj neve nuk mund të na hapen dyert e BE-së! Ata shtuan edhe një gjë tjetër, që ky proces jo vetëm do të kalojë përsëri në Komision, në Parlament, dhe më pas te Këshilli, por parlamenti gjerman dhe holandez theksuan qartësisht edhe forcimin e kontrollit të tyre direkt në këtë proces, sepse nuk kanë besim te ne, sepse ju keni krijuar mosbesueshmëri, sepse ju e keni djegur besimin para se ata të japin mendimet e tyre. Pra, ku jemi? A jemi në të njëjtën situatë si në vitin 2016? Jemi më keq, zoti Ministër, sepse na janë shtuar elemente të tjera dhe na është thënë qartësisht se do të shikohet implementimi i procesit zgjedhor; na është thënë qartësisht në një paragraf për kultivimin e drogës. Nga ana tjetër, çfarë po ndodh? Si janë precedencat? Janë shumë të rrezikshme.

A i keni parë mediet italiane pak ditë më parë? Ato thoshin: “Shqipëria, linja kryesore e Europës për furnizimin me kanabis. Po kthehet edhe në linjën kryesore të trafikut të drogave të forta, të krimit, që po sundojnë vendin tonë”. Ju mendoni se në këtë mënyrë do të qëndroni ende

në qeverisje?! Ju mendoni se duhet të qeverisni në këtë mënyrë?! Sa do të qëndroni?! A nuk do të ishte më e ndershme që të thoni: “Po largohemi, po japim dorëheqjen, sepse dështuam”. Të dështosh në elementin kryesor të një qeverie, do të thotë se çdo qeveri në botë do të kishte rënë dhe nuk do të mund të kishte qëndruar në pushtet.

Mimi Kodheli - Zoti Shehu, a doni përgjigje për pyetjet?

Tritan Shehu - Janë pyetje retorike.

Mimi Kodheli - Në rregull!

Tritan Shehu - Pyetja e vetme është: kur do të jepni dorëheqjen?

Mimi Kodheli - A doni përgjigje?

Tritan Shehu - Ju mendoni se do të fshiheni pas Malit të Zi dhe pas Serbisë? Nuk është e vërtetë. Për Malin e Zi në vitin 2011 Bundenstagu gjerman u shpreh qartësisht dhe është e shkruar: “I rekomandojmë Këshillit që të hapen negociatat dhe problemet të zgjidhen më tej”. Pas 6 muajve fazë përgatitore, ata caktuan datën, kurse Shqipëria nuk ka asnjë datë.

Mos u krahasoni me Serbinë, sepse edhe ajo është përpara në këtë rrugë. Serbia ka probleme me Kosovën, ka probleme të jashtme, kurse problemet tona nuk janë të tilla, sepse ato vijnë nga keqqeverisja e brendshme, nga krimi i brendshëm, nga korrupsioni, nga shkatërrimi i sistemit të drejtësisë, nga droga. Pra këto janë problemet tona që ju e katandisët kështu.

Zoti Ministër, ju, gjithashtu, tentuat të mashtronit opinionin publik atë ditë që u dha vendimi i Këshillit! Kjo nuk është serioze për ju.

Ju bëtë një postim duke thënë “Fituam”. Po, është e vërtetë, sepse edhe komunistët kështu thoshin gjithmonë: “Disfatën do ta kthejmë në fitore”, por ju mashtruat! Ju duhet të ishit transparent me njerëzit, ju duhet të ishit të qartë me njerëzit dhe t’u thoshit se ne dështuam. Shqipëria dështoi për fajin tuaj. Ky është problemi dhe kjo është e vërteta! Pra, një arsye më shumë që ju duhet të jepni dorëheqjen.

Ju kërkoni sot që të fshiheni pas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Po bëni një gabim të madh: po diskreditoni dhe po zhvlerësoni Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, ku po na kërkohet edhe njëherë ekzaminimi i saj, sepse ju po shkeli pika të rëndësishme të kësaj marrëveshjeje. A e lexuat para pak ditësh gazetën më të prestigjioze italiane “Il Giornale d’Italia”? A e patë se çfarë shkruhej për ligjin që ju miratuat për tjetërsimin e pronave, për Teatrin? Në të shkruhej se po shkelet rëndë Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Me këtë rrugë që keni nisur ju jo vetëm po largoheni çdo ditë nga negociatat, por po vini në dyshim edhe vetë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

“Il Giornale d’Italia” nuk është një gazetë e thjeshtë, që lexohet në kafene, por është një gazetë, e cila, realisht, ka nja *background* nga pas shumë të rëndësishëm politik.

Nuk po zgjatem më shumë, sepse dua t’u lë hapësirë edhe kolegëve për të folur më specifikisht për sektorë të ndryshëm, për probleme më konkrete, por do të them vetëm një gjë: çdo qeveri e përgjegjshme, në qoftë se do t’i kishte mbetur sado pak përgjegjshmëri, do të kishte thënë: “Dështuam, ndaj po japim dorëheqjen, që të mos i bëjmë më shumë dëme këtij vendi, sepse ky vend nuk e meriton”

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Shehu!

Zoti Ministër, fjala për ju!

Ditmir Bushati - Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, në mënyrë telegrafike, zbatimi i Marrëveshja e Stabilizim- Asociimit as nuk vlerësohet dhe as nuk është objekt ekzaminimi i gazetave, sado prestigjioze qofshin ato.

Në bazë të nenin 116 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Këshilli i Stabilizim-Asociimit është organi më i lartë vendimmarrës, i cili merr në shqyrtim, në mënyrë vjetore, nivelin e zbatimit të detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Mbledhja e Këshillit pasohet edhe me konkluzione të përbashkëta.

Unë e vlerësoj edhe ankesën, edhe kërkesën që ka bërë një grup deputetësh të PD-së për të filluar hetimin ndaj Shqipërisë për një çështje të caktuar, ku ky grup deputetësh pretendon aplikimin e skemave të ndihmës shtetërore, në kundërshtim me detyrimet që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Si bashkëdrejtues i Këshillit të Stabilizim- Asociimit në rast se do të ndiqet praktika, që duhet të ndiqet, dhe jo praktika që kanë ndjekur deputetët e PD-së, unë i ftoj në zyrën time të gjithë firmëtarët dhe do t’i asistoj se si mund të shkojnë drejt aktivizimit të Këshillit, sepse vetëm ai merr vendime dhe askush tjetër për sa i përket nivelit të zbatimit të detyrimeve.

Së dyti, e ndaj plotësisht analizën gjeopolitike, gjeostrategjike, gjeoeconomike në lidhje me zhvillimet në rajon, vetëm se duhet të jem i saktë dhe preciz për gjërat që u thanë këtu. Ju lutem, në rast se doni që t’u referoheni qëndrimeve të komisionerit Hahn, referojuni deri në fund deklarimeve të tij! Një tjetër koleg doli këtu dje dhe tha: “Këtij po i mbaron mandati”. Është

normale që në fund të ditës të kesh kundërshti, prandaj demokracia ka magjinë e saj. Partia ku ju bëni pjesë ka një traditë shumë të vyer në kursin konfliktual me përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare. Kjo është zgjedhja juaj, nuk më takon mua ta komentoj, por në rast se duam që t’u referohemi qëndrimeve të komisionerit Hahn, ai dje në konferencën për shtyp foli qartë për modelin që po përcakton Shqipëria me reformën në drejtësi.

Ju keni shumë të drejtë, i nderuar, zoti Shehu, që jeni i shqetësuar për faktin se Gjykata Kushtetuese ka mbërritur në këtë ditë, pas procesit të vetingut, por edhe si jurist bashkohem me shqetësimin tuaj, që një vend pa Gjykatë Kushtetuese, nuk është një lajm i gëzueshëm për asnjë qytetar të zakonshëm të këtij vendi por, nga ana tjetër, duhet t’i themi gjërat ashtu siç janë. Mua më vjen turp kur shikoj që procesin e vetingut, qoftë për çështje pasurie, qoftë për çështje penalteti e kështu me radhë, nuk e kalojnë dot shumica e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese apo të Gjykatës së Lartë. Në bazë të rekomandimeve që dalin nga procesi i vetingut, nga Komisioni Europian apo sipas konkluzioneve të Këshillit të Ministrave, që juve iu referuat këtu, Shqipërinë e përmendin si histori suksesi dhe si model për t’u vendosur nga vendet e tjera. E gjithë kjo punë duhet të na shërbejë si ushqim për të menduar se si mund ta përmirësojmë cilësinë njerëzore në Gjykatën e ardhshme Kushtetuese dhe në Gjykatën e ardhshme të Lartë të Republikës së Shqipërisë. Thirrja e komisionerit dje për të votuar ligjin, që zhbllokon funksionimin normal të Shkollës së Magjistraturës, nuk ishte një thirrje për të mbështetur as qeverinë dhe as planin që ju e pikturuat në formë ogurzeze për të marrë institucionet e drejtësisë.

Së treti, juve iu referuat rolit të Bundenstagut gjerman. Atëherë, do të ishte gjëja më e fundit që unë të bëja pedagogji në këtë seancë për këtë proces. Po ju them se edhe këtu jeni i pasaktë. Unë nuk e marr guximin që të përdor epitetet që përdorët ju, si “mashttrim:” e të tjerë, por po ju them se jeni i pasaktë.

Precedenti i parë që është vendosur për një përfshirje më të madhe të Bundenstagut gjerman për sa i përket këtij procesi, ka lidhje të drejtpërdrejtë me Serbinë. Për shkak të ndërhyrjes të Bundenstagut gjerman dhe për shkak të mandatit që qeveria gjermane kishte në Këshill, vendosi në tryezën e bisedimeve kapitullin 35, si kapitull të parë për fillimin e bisedimeve për anëtarësimin me Serbinë.

Ju morët përsipër dhe folët këtu për pozicionin e qeverisë gjermane. Qeveria gjermane ka folur në Këshill dhe gjej rastin ta falënderoj edhe njëherë ka qenë lokomotiva. Ju thoni se Bundentagu po na bllokoi, por unë po ju them se qeveria gjermane ka qenë lokomotiva për hapjen

e menjëhershme të negociatave, sepse e ka thënë publikisht për 25 vendet që kanë qenë për hapjen e menjëhershme.

Të dielën unë do të mirëpres ministrin gjerman në Tiranë dhe mbase do të keni mundësi ta dëgjoni kur ta thotë sërish. Ndoshta ju nuk e keni me qejf nga deklaratimet që ai ka bërë në Luksenburg dhe në Bruksel. Mediet shqiptare do të jenë të ftuara për ta dëgjuar vetë qëndrimin e qeverisë gjermane, me shpresën që forca juaj politike nuk do të bëjë të njëjtin gabim që bëri me Zig Mark Gabrielin dhe me Frank Valtersen Majerin, që kur bënë deklaratimet në Tiranë u konsideruan si njerëz me axhendë të tyre, sepse në Gjermani kishin *grand coalition* dhe nuk mbanin qëndrimin e kancelares Merkel.

Ju mendoni se këto gafa që bëni nuk shënohen. E keni gabim, sepse të gjitha shënohen, një për një. Më pëlqeu shumë fjala “ëndërr që ngadalësohet”, sepse m’u duk një shqipe e pastër, prandaj e fiksova që ta kem, se mund të më duhet. Është hera e parë që e dëgjoj shprehjen “ëndërr që ngadalësohet” dhe jam i bindur se rilindësit tanë do ta kishin zili këtë lloj stili.

Meqenëse përmendët negociatat, mendoj se kjo ëndërra që po ju ngadalësohet duhet të ishte një stil prej rilindësi në Partinë Demokratike.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Fjalën e ka zonja Gjoshë.

Më pas e kanë zonja Kushi, zoti Panariti e kështu me radhë!

Klajda Gjoshë – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Ministër, faleminderit që jeni sot këtu për të dhënë shpjegime për procesin e negociatave dhe për dy samite!

Të them të vërtetën, ju dëgjoj gjithmonë me vëmendje, edhe për arsye të pozicionit që unë kam mbajtur më parë, por e kam të vështirë të impresionohem nga mënyra e komunikimit tuaj apo nga organizimet tuaja, sado të bukura dhe të shtrenjta të jenë, të cilat janë harxhime të buxhetit të shtetit dhe të taksapaguesve shqiptarë, për të krijuar ato ambiente madhështore pritjeje, sikur vendi u bë anëtar i Bashkimit Europian. Por, edhe sikur të ndodhte një ditë, përsëri ne duhet të ishim mjaft modest dhe të kujdesshëm, sepse ky është një vend i varfër dhe vuan për bukën e gojës, që të mos organizojmë tryeza me mijëra individë dhe me adezive të printuara me ngjyrat nga më të shtrenjtat që ekzistojnë.

Takimi i djeshëm duhet të ishte një takim teknik, ku nuk ishte e nevojshme të ishte e gjithë qeveria, me zëvendësministrat dhe sekretarët e Përgjithshëm, të cilët janë punonjës administrativë

dhe kanë punët e tyre për të kryer në ministrinë përkatëse, por duhet të ishte një takim mes jush, Kryeministrit dhe ekipit kryesor, që do të koordinojë këtë proces, por edhe të zëvendësministrit të ri, meqë keni filluar t'i ndërroni ata çdo 6 muaj, të cilët duhet të koordinojnë procesin e integritetit dhe që janë thelbësore në këtë proces.

Ministria u shkri për një arsye, ndërsa tani shkrihen të gjithë individët që merren me këtë proces dhe zëvendësministrat ndërrohen çdo 6 muaj dhe çorientohet e gjithë administrata publike.

Më në fund u tha dhe një fjali që ishte me vend, ku u citua, pavarësisht se nuk kam nevojë të më përmendet emri dhe as ministria të cilën drejtoja, sepse këto janë dokumente që nuk i punoj unë si individ, por punohen nga grupe ekspertësh, një strategji, e cila ka 2 vjet që qarkullon në ministrinë tuaja dhe në zyrën e Kryeministrit, që duhet të kishte filluar të vihej në zbatim, sepse sot vihemi përpara një fakti ku themi: kemi 9 muaj kohë dhe Shqipëria nuk ka shumë kohë, prandaj duhet ta implementojmë sa më shpejt, prandaj gjithmonë e implementojmë gabim, sepse asnjëherë nuk ka kohë, nuk ka njerëz dhe nuk janë kapacitetet e duhura për t'i bërë gjërat në kohën e duhur.

Zoti Ministër, duhet patjetër të merreni me administratën publike, pavarësisht se negociatat nuk janë hapur. Ju kam dëgjuar disa herë në Kuvendin e Shqipërisë të deklaroni që ishte fitore e madhe çeljo e negociatave. Jo, nuk janë çelur negociatat.

Flisni për procesin *screening*, të paktën shqipërojeni këtë fjalë që ta kuptojnë edhe qytetarët. Ky është një proces teknik dhe i natyrshëm, që ndodh brenda ministrisë tuaj, brenda të gjithë njerëzve që merren me procesin e integritetit europian dhe ka të bëjë me përafrimin e legjislacionit, i cili është i përditshëm. Nuk është një proces ku ne duhet të vendosim flamur dhe të marrim triumfe, sepse fituam dhe arritëm pikën më të lartë të procesit të integritetit. Nuk është kështu.

Dëgjova këtu të diskutohet për hapje dhe mbyllje kapitujsh. Ne nuk jemi në atë fazë, absolutisht jo. Por, përkundrazi, Kryeministri para se t'ju deklaronte koordinator të këtij procesi madhor për hapjen e negociatave, duhet t'ju deklaronte koordinator për të vendosur pikat mbi "i" për të gjitha ato institucione që janë përgjegjëse për 5 prioritetet dhe kushtet që Shqipëria do të përgjigjet, një për një, në qershorin e ardhshëm. Duam apo nuk duam ne, aty janë disa kushte që janë shumë të vështira për t'u përmbushur, sepse kanë të bëjnë me krimin e organizuar, me korrupsionin dhe me reformën në drejtësi, e cila tashmë është në ngërç. Nuk është ndonjë dëshirë e madhe të themi: jemi pa Gjykatë Kushtetuese, pa Gjykatë të Lartë dhe nesër do të jemi edhe pa Gjykatë Apeli, a e imagjinoni dot se çfarë do të ndodhë në këtë vend? Ndoshta mund t'u pëlqejë,

ndoshta kjo është ëndrra e çdo Kryeministri, të drejtojë një qeveri me drejtësinë në dorën e tij, pa pasur asnjë institucion që nesër mund ta bëjë atë përgjegjës. Po, është e vërtetë, por kjo nuk do të thotë që Shqipërisë iu çelën dyert e Bashkimit European, vetëm se ne vazhdojmë të bëjmë hapa prapa në këtë proces.

Unë ju bëj thirrje që përpara se të kalojmë tek i gjithë procesi i analizës për përafrimin e legjislacionit, të cilin duhet ta bëni ju dhe të gjithë njerëzit që punojnë në ministri, duhet të merreni urgjentisht me plotësimin e kushteve dhe me një raport tjetër, që kërkojnë konkluzionet e këshillit, që ka të bëjë me çështjen e azil kërkuesve. E kam përmendur në disa dalje të miat medietike dhe dua t'ju a ritheksoj, që është një çështje madhore, e cila i kërkon Komisionit European madje edhe Këshillit, që të raportojë posaçërisht për këtë çështje. Është një nga problematikat që nesër Shqipërisë mund t'i kushtojë lëvizjen e lirë në BE. Mos më thoni që nuk është e vërtetë, po të doni jua lexoj fjalë për fjalë se çfarë shkruhet, madje nuk kam nevojë ta lexoj, sepse e di përmendesh se çfarë komunikohet.

Bëni kujdes, sepse vendimi për Shqipërinë nuk do të jetë më vetëm në Komisionit European dhe më pas në Këshill, por ka edhe një hallkë tjetër (për ata që dinë ta lexojnë dhe besoj se ju jeni nga ata persona që dini të lexoni konkluzionet e vendeve të Bashkimit European), që janë parlamentet anëtare, të cilat kanë dyert e hapura dhe kanë mundësinë për t'u shprehur dhe për të ratifikuar, ata të parët, nëse Shqipërisë do t'i çelen negociatat dhe më pas të kalojë në Këshill dhe në krerët e vendeve anëtare. Unë besoj që kjo është një çështje madhore, sepse, kur ne nuk arrijmë të bindim 27 vende anëtare, imagjiloni të bindim mijëra anëtarë të parlamenteve që kontrollojnë dhe monitorojnë mënyrën se si vepron dhe se si ecën Shqipëria, për sa u përket prioritetëve kyçe dhe përgjigjeve që ne duhet të japim për çdo kusht të vendosur në atë konkluzion.

Edhe diçka tjetër, ju dëgjoj shpesh të krahasoni Shqipërinë me Serbinë dhe Malin e Zi. Unë them mos e bëni këtë. Kanë kaluar disa vite dhe Shqipëria po hyn në ato rastet unike, të cilat po ndyshojnë edhe mënyrën sesi po devijon dhe po vazhdon procesi. Vërtet na u dha një mundësi për të kryer procesin teknik të përafrimit të legjislacionit dhe të analizës, por nuk do të thotë që kemi një datë për çeljen e negociatave. Plotësoni kushtet dhe pastaj merrni datën për çeljen e negociatave dhe ejani ta festojmë së bashku, sepse edhe ne të lumtur do të ishim, sikur Shqipëria të ishte një hap më afër Bashkimit European.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Edhe unë ndaj të njëjtin mendim me fjalinë e fundit dhe do të ishim shumë të lumtur që ta festonim së bashku, sepse kush më shumë sesa zonja Gjoshë, e cila deri pak muajsh e drejtonte këtë strukturë, e di se për çfarë po flasim.

Fjalën e ka zoti ministër, pastaj e ka zonja Kushi dhe zoti Panariti.

Ditmir Bushati – Realisht, edhe unë e ndaj gëzimin tuaj, kjo shikohet edhe në sytë e secilit prej jush dhe nuk ka asnjë vështirësi në këtë drejtim.

Për të qenë i saktë dhe preciz, e para, i referoheni çështjes së azilkërkuesve, por e keni gabim, lexojeni deri në fund atë çfarë tha dje komisioneri, mos u merrni me fundin e mandatit të tij, për këtë çështje.

Së dyti, nëse nuk besoni komisionerin, duhet t'i referoheni raportit të Komisionit Europian të fillimvitit; nëse nuk i përmbaheni dhe nuk keni besim tek Komisioni Europian, mund t'i referoheni raportit të qeverisë franceze, sepse problematika për këtë çështje ishte me Francën. Kjo është një çështje, e cila është adresuar në mënyrën më profesionale të mundshme nga ana e Shqipërisë, si në planin politik, duke e njohur si fenomen dhe duke marrë përgjegjësi, ashtu edhe në planin operacional. Kjo nuk është një çështje emergjente, nuk është në tryezën e bisedimeve sot për sot dhe nuk ka asnjë rrezik, përveç panikut ose mosdijes që ju doni të përhapni, i cili mund të vendosë në pikëpyetje procesin e liberalizimit të vizave.

Së treti, thoni për parlamentet, më vjen shumë keq, sepse keni qenë edhe ministër e Integritetit Europian për katër vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Realisht më vjen shumë keq për ju, kur e ka thënë kryetarja e partisë suaj nuk e kam vënë re, sepse nuk kam pritur të kishte një gjykim esell për këtë çështje. Ajo është një frazë shabllon, të cilën konkluzionet e Këshillit e përdorin për rastin e Serbisë, Malit të Zi, Shqipërisë dhe Maqedonisë. Përse? Edhe në NATO u bë një diskutim i zjarrtë në lidhje me kontributet financiare. Nuk është më sekret të thuhet që Shtetet e Bashkuara të Amerikës këmbëngulin që disa prej vendeve anëtare të NATO-s të rrisnin shpenzimet dhe shumica e krerëve që ishin aty iu referuan procedurave të tyre të brendshme kushtetuese.

E kam shpjeguar edhe në një aktivitet tjetër, që ka vende si Gjermania që me precedentin e vendosur në rastin e Serbisë dhe me ligjin që ka miratuar Bundestagu gjerman, për bashkëveprimin mes qeverisë dhe Bundestagut në çështjet e integritetit europian, duhet që në çdo rrethanë qeveria të marrë një mendim nga ana e Bundestagut për këtë çështje. Kjo është arsyeja

përse konkluzionet e Këshillit i respektojnë ekzigjencat kushtetuese që mund të kenë vende të ndryshme anëtare.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, meqë këtu u bë diskutimi për ngjyrat e shtrenjta, unë nuk e di se cilat janë ngjyrat e shtrenjta dhe të varfëra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, qetësohu, që të respektojmë njëri-tjetrin. Përse duhet të jetë ky axhitim?

E para, për sa i përket tryezës, aty ishte flamuri shqiptar dhe ai i Bashkimit Europian.

E dyta, është e njëjta tryezë ku je ulur edhe ti, në krahun tim apo të Kryeministrit, që ne kemi përdorur me qeverinë e Kosovës. Nuk mbaj mend që ti apo ndonjë prej kolegëve të nderuar të LSI-së, që uleshit me ne në tavolinë, të keni pasur ndonjë pretendim të tillë në atë kohë. Megjithatë, në funksion të respektimit maksimal të opozitës, unë do ta mbaj shënim edhe këtë çështje për të kuptuar se cilat janë ngjyrat e shtrenjta dhe ato të varfëra.

E fundit fare, meqë po flasim për shterimin, u tha që procesi *sreening* dhe procesi i përafrimit të legjislacionit qenkan procese teknike. Po ju them, por mund t'i lexoni të gjitha komentet që janë bërë dje për këtë gjë, si nga ana e komisionit e të tjerë, që procesi i përafrimit të legjislacionit nuk është proces teknik, është proces politik, është ambicia e një vendi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, ka filluar që në vitin 1990 dhe nuk e mohon njeri këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është ambicia e një vendi për të përafruar standardet e veta me standardet më të larta dhe është një proces unilateral i njëanshëm. Nuk është procesi tipik që ndodh në një marrëdhënie ndërkombëtare, nuk ka reciprocitet dhe më vjen keq që detyrohem të them gjëra bazike në këtë proces. Tani po filloj të kem pikëpyetje të tjera për katërvjeçarin e shkuar. Të thoni që procesi *screening* bëhet brenda mureve dhe ka lidhje vetëm me nuklën koordinuese, nga ana tjetër thoni: zbatoni këto standarde dhe tek ato standarde përmendni reformën në drejtësi, më pas thoni: shikoni si po e lini vendin pa Gjykatë Kushtetuese, a thua se po i cenohen të drejtat ndonjë gjyqtari në vend, më falni që po ju them, por kjo është e papranueshme për Shqipërinë e shekullit 21. Ne duhet të skuqemi njëlloj para të gjithë atyre gjyqtarëve që nuk përmbushin kriterin për të qenë gjyqtarë. Ata kanë sallën e apelimit, siç ishte rasti i djeshëm, le të shkojnë në sallën e apelimit, kanë edhe Gjykatën e Strasburgut, por nuk është diskutimi ynë. Diskutimi ynë është ligji "Për Shkollën e

Magjistraturës” dhe si të ndërtojmë institucione të drejta dhe të ndershme që t’i shërbejnë të gjithë shqiptarëve. Kjo është sfida jonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Fjalën e ka zonja Kushi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tritan Shehu – Kërkoj fjalën për procedurë.

Mimi Kodheli – Nëse doni që kjo mbledhje të vazhdojë siç është në traditën e mbledhjeve të këtij komisioni, unë ia kam dhënë fjalën zonjës Kushi dhe më pas zotit Panariti, vetëm pas tyre ju mund të merrni fjalën për procedurë.

Tritan Shehu – Kam të drejtën e fjalës për procedurë, sepse në Rregullore thuhet: “Për procedurë i jepet fjala menjëherë sapo e kërkon”. Kjo është Rregullorja. Nëse doni ta kthejmë në një teatër dhe të mbajmë dy orë leksione dhe të mos themi asgjë, atëherë kjo është çështje tjetër. Unë do të them dy fjalë për procedurë dhe kaq.

Mimi Kodheli – Jo, unë insisto.

Tritan Shehu – Ju mund të insistoni sa të doni, rëndësi ka të respektoni Rregulloren.

Mimi Kodheli – Unë kam anoçuar për t’i dhënë fjalën...

Tritan Shehu – Ju mund të anonçoni edhe 10 veta, por në Rregullore është e shprehur qartësisht.

Mimi Kodheli – Mbledhjen e drejtoj unë. Zoti Tritan, edhe një herë po ju them, nëse doni që mbledhja të vazhdojë në mënyrë korrekte, siç janë zhvilluar të gjithë mbledhjet, por edhe në respekt të kolegut Pollo, të cilin me shumë dëshirë e kam ftuar të jetë pjesë e këtij komisioni, ne do të vazhdojmë. Kohën e patët të mjaftueshme dhe nuk ju ndërhyri njeri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne do të vazhdojmë me kolegët dhe ju mund ta merrni përsëri fjalën më pas, përndryshe ju njoftoj që seancën dëgjimore e mbyll këtu.

Tritan Shehu – Mbylleni nëse dëshironi, sepse nuk keni çfarë të thoni, sepse dështuat, ja përse.

Mimi Kodheli –. Zoti Ministër, faleminderit për prezencën!

Seanca dëgjimore mbyllet.

Faleminderit.

MBYLLET MBLEDHJA